



# Suksesi i «e.a.Partners AG» vjen falë punës korrekte dhe transparencës

«Të mos shikojnë vetëm diplomën, por të kërkojnë profesionistë, të ju shikojnë edhe punën që e kanë bërë». Kjo është këshilla që arkitektët Kelmend Abazi dhe Flamur Elmazi u japin të interesuarve për të

**S**e bashkimi i bën njëzëritë më të fortë dhe më të suksesshëm këtë më së miri e dëshmojnë edhe arkitektët Kelmend Abazi dhe Flamur Elmazi, njëri me origjinë nga Kërçova e tjetri nga Struga. të cilët për disa vite radhazi punojnë së bashku në Zvicër. Të dy janë arkitektë të dalluar në punët e tyre. Ata veprojnë në një firmë që e krijuan bashkë -«a Partners AG» në Zürich.

Kur i pyet se sa e veshtrë është të funksionojnë punët në partneritet, ata thonë se të punosh me një partner është gjëja më e thjeshtë dhe se e gjitha që duhet, është respekti, përkushtimi dhe sineriteti ndaj njëri-tjetrit.

Projektet e tyre në bashkautorësi shtrihen në disa qytete të Zvicrës, sidomos pas vitit 2010.

Në një intervistë për albinfo.ch ata kanë shpalosur punën e tyre ndër vite së bashku dhe suksesin që kanë arritur, që kur kanë filluar biznesin e tyre.

Punën e tyre e pëlqejnë të gjithë, përfshirë këtu edhe kompani të media prestigjioze zvicerane. Prandaj, nuk ka rëndësi në qoftë se i kontraktori për një rinovim të shtëpisë apo ndërtim nga themeli, ata do të ofrojnë më të mirën, që klienti të ndabet i kënaqur.

Flamuri dhe Kelmendi, në intervistën për albinfo.ch flasin për veshtrësitë dhe

përparësitë që ka biznesi i ndërtimeve në Zvicër dhe sa i kushtojnë rëndësi shqiptarë arkitekturës, për të veçantat e kësaj pune, si dhe për synimet për të ardhmen. Duke shpalosur ofertat e kompanisë që udhëheqin prej 7 vjetësh, Kelmendi dhe Flamuri, tregojnë se bëjnë më shumë punë se sa arkitektët ngase ata janë edhe përgjegjës për planifikimin e objekteve, për realizimin e tyre dhe menaxhimin e shpenzimeve gjatë ndërtimit.

**Albinfo.ch: Cilën punë e keni më për qejf, rinovimin apo ndërtimin nga themeli?**

**Kelmend Abazi:** Ka projekte të ndryshme

dhe varet nga projekti. Disa dalin më të bukur në qoftë se rinovohen dhe disa të tjera në qoftë se punohen nga fillimi. Mirëpo ne nuk e kemi problem asnjërin.

**Flamur Elmazi:** Përparësia e jonë është se ne e kemi prioritetin koston e projektit dhe se ata do të përfitojnë pronari nga ky projekt. Kjo është analiza e parë që e bëjmë. Pastaj ne e prezantojmë të pronarët që e kemi punuar dhe të fundi i mbetet vetë pronarit të marrë vendimin.

**Si vendosët të punoni së bashku?**

**Kelmend Abazi:** Në fillimisht u njohuam në vendin ku punonim dhe pastaj vendosëm që të bëjmë diçka bashkë. Kemi tërë vite që zyrtarisht punojmë së bashku në firmën tonë të përbashkët, ndërsa 10 vite në përgjithësi.

**Si keni arritur të funksiononi për kaç gjatë së bashku?**

**Flamur Elmazi:** Falë sineritetit dhe punës së hapur. Ne nuk mbajmë të fshehur asgjë nga njëri-tjetri dhe nuk jemi të lidhur familjarisht pas gjërave. Ne na lidhë profesioni dhe biznesi dhe çfarëdo që të vendosim, e vendosim së bashku, asnjë vendim nuk merret pa pëlqimin e të dyve.

**Cila ka qenë oferta e parë për plan të shtëpisë apo objekti?**

**Flamur Elmazi:**... për një turk ka qenë. Rinovim shtësie. Ky ka qenë d.m.th projekti i

parë, i realizuar në vitin 2012. Dhe falë punës sonë, është zgjeruar rrethi i klientëve dhe kemi vazhduar tutje.

**A ka arkitektë të këqij?**

**Kelmend Abazi:** Si në çdo profesion edhe në profesionin e arkitektit ka të mirë dhe të këqij. Po ashtu shpesh bëhet ngatërrim në mes të një ndërtuesi dhe një arkitekti. Dhe ka dallim, është ndryshe kur punon me një arkitekt dhe ndryshe me një ndërtues (Generalunternehmer). Në portofolion tonë janë së paku tërë vite studimi dhe eksperienca.

**A ka ndodhur që ta keni punuar një projekt dhe nuk është pranuar nga klientët.**

**F.K:** Arkitekti i keq e punon një projekt mund të themi pa bashkëpunim me klientin, e te ne kjo gjë nuk ndodhë sepse ne veprojmë në parim «duke punuar duke i treguar» çdo gjë e bëjmë së bashku me klientin. Çdo projekt që e bëjmë ne është specifik, nuk ka «copy paste» në punën tonë.

**Albinfo.ch: A i ndërtoni shtëpitë sipas stilit të juaj apo sipas trendit?**

**Kelmend Abazi:** Ne nuk e ndjekim asnjëherë trendin. Ne i përshatemi lagjes, klientit dhe normalisht që ka modernizime dhe shikojmë me kohën ndërsa fjalën e fundit e ka gjithnjë klienti.

**Te ne nuk ka «copy paste»**

Arkitekti i keq e punon një projekt mund të themi pa bashkëpunim me klientin, e te ne kjo gjë nuk ndodhë sepse ne veprojmë në parim «duke punuar duke i treguar» çdo gjë e bëjmë së bashku me klientin. Çdo projekt që e bëjmë ne është specifik, nuk ka «copy paste» në punën tonë.

**Albinfo.ch: A përshatet gjithnjë hapësira që e keni të disponueshme me idetë e juaj?**

**Flamur Elmazi:** Gjithnjë jo, ne mundohemi në shumicën e rasteve, por janë kritere të cilave ne duhet t'i përmbahemi dhe rregulloret në fuqi të komunës, të dhënat e parregullt dhe shija e pronarit. Rregulloja dhe normat të kufizojnë më shumë dhe ne duhet t'u përmbahemi.

**Çfarë i këshillojnë ata që janë në kërkim të një arkitekti?**

**Kelmend Abazi:** Të mos shikojnë vetëm diplomën, por të kërkojnë profesionistë, të ju shikojnë edhe punën që e kanë bërë dhe në rëndësi shpesh ndër të gjitha është «kimi» ndërmjet pronarit dhe arkitektit. Pastaj, një arkitekt duhet të jetë i hapur dhe të fitojë besimin e klientit. Një klient i pakënaqur t' i tremb 15 klientë tjerë ndërsa një i kënaqur t' i sjellë shtatë klientë tjerë.

**Të zgjedhësh një arkitekt që është i ri por më afër modernes apo një tjetër që ka eksperienca por që ndoshta nuk është shumë bashkëkohor?**

**Kelmend Abazi:** Varet nga pronari, në qoftë se t' i sponn diçka super moderne dhe besë kohëzgjatës nuk ka rëndësi, atëherë pranoi një arkitekt të ri. Për ne klienti është mbreti, ndërsa puna jonë është ta udhëzojmë t' i afrojmë një zgjidhje që për të dyja është e pranueshme. Nganjëherë idetë e klientëve janë ajo joreale sa që ne kërkim një zgjidhje me kjo që e duhet për shumë arsye.

